



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:085839

Datë: 29.04.2023

Numri i dokumentit: 04236671

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.326/21

GJYKATA THEMELORE PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me procesmbajtëse Shpresa Kërnye në çështjen penale kundër të pandehurve Xh. H. dhe I. H. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së ndërsa për të pandehurin N. M. për vepër penale Lëndim i rendë trupor nga neni 186 par.1 lidhur me nenin 1.3 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.472/21 të datës 30.04.2021, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 27.04.2023 në prezencë të prokurorit së shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit Xh.H., I. H. dhe N. M. me mbrojtës Av.Mustafë Kastrati, me datë 28.04.2023 shpalli dhe përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

Të pandehurit:

1.XH. H., i atësisë H., i lindur me në S., me vendbanim në Pejë, rr “M. C.” nr-..., i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me profesion profesor, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

2. I. H., i atësisë H., i lindur me në S., me vendbanim në Pejë, rr “M. C.” nr-..., i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me profesion punëtor në PTK, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, dhe

3. N. M., i atësisë K. dhe amësisë Sh. e vajzërisë K., i lindur me në Pejë, ku edhe jeton, rr “A. Q.”, pronar i autosallonit “M. AG” në Pejë, ka të kryer shkollën e mesme, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLËN FAJTOR

Për shkak se :

Të pandehurit Xh. H. & I. H.

Me dt. 14.02.2021, rreth orës 15:20 minuta, në Pejë, në rr “E. M.”, me dashje i shkaktojnë lëndime të lehta trupore të dëmtuarit N. M., në atë mënyrë që pas një zënke të çastit në mes të dëmtuarit dhe të pandehurit I. H., ky i fundit e sulmon fizikisht duke e goditur me grushta në fytyrë ku më pas aty i bashkangjitet edhe i pandehuri Xh. i cili po ashtu e sulmon fizikisht të dëmtuarin duke e goditur me grushta në fytyrë, ku si pasojë e kësaj të njëjtit i shkaktojnë ndrydhje të indeve të buta të anës së majtë të regjionit ballor të kokës, gërvishtje dhe dërmishje lëkurore të regjionit të syrit të djathtë, dhe si të tilla bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore me dëmtime të përkohshme në shëndet.

-me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par 1 lidhur me nën.par 1.4 dhe nenin 31 të KPRK-së.

I Pandehuri N. M.

Me dt 14.02.2021, rreth orës 15:20 minuta, në Pejë, në rr “E. M.” me dashje i shkakton lëndime të rënda trupore të dëmtuarit Xh. H., në atë mënyrë që pas një zënke të çastit në mes të të dëmtuarit dhe të pandehurit N. M., dhe përderisa i dëmtuari e kishte ngritur dorën e djathtë që të mbrohet, i pandehuri e sulmon fizikisht duke e goditur me grusht në gishtin e vogël të dorës së djathtë ku si pasojë e kësaj të njëjtit i shkakton ndrydhje të indeve të buta të shuplakës së dorës së djathtë, thyerje me zhvendosje të fragmentit të bazës së falangës së poshtme në gishtit të vogël (gishti i pestë) të shuplakës së dorës së djathtë të cilat si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore.

-me çka ka kryer veprën penale Lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par. 1 lidhur me nën.par 1.3 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (O6/L-074):

GJYKON

I. Të pandehurit Xh. H. i shqipton:

DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej dy (2) vitesh, qe do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Te pandehurit I. H. i shqipton:

DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej dy (2) vitesh, qe do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Te pandehurit N. M. i shqipton:

DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR ne kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 4 (katër) vitesh, qe do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV. Obligohen të dënuarit qe secili veç e veç në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën nga 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguajnë shumën nga 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

V. Kërkesë pasurore juridike nuk pati nga të dëmtuarit.

ARSYETIM

A. Historiku i çështjes dhe vendimi ne lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 30.04.2021 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.472/21 kundër të pandehurve Xh. H. dhe I. H. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së ndërsa për të pandehurin N. M. për vepër penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.1 lidhur me nenin 1.3 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 27.04.2023 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit Xh. H., I. H. dhe N. M. me mbrojtës Av. Mustafë Kastrati, në të cilën seancë të pandehurit u deklaruan se e pranojnë fajësinë për veprat penale që u vihen në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit në kuptim të nenit 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehurit, pasi që është e qartë se e kuptuan natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Pas aprovimit të pranimin të fajësisë nga ana e gjykatës, prokurori i shtetit deklaroi “ Me qenë se të e pranuan fajësinë konform kushteve ligjore të parapara me nenin 242 të KPPRK-së, nga Gjykata kërkoj që të akuzuarit ti shpall fajtor ti dënoj sipas ligjit si dhe ti obligoj në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethanë lehtësuese të vlerësoj pranimin e fajësisë, keqardhjen e shfaqur nga tre të akuzuarit, në raport me njeri tjetrin, faktit se të njëjtë janë pajtuar dhe kanë marrëdhënie shumë të mira në mes vete, po ashtu edhe rrethanat personale dhe karakterin e të pandehurit Xh. i cili është intelektual dhe mësimdhënës”.

Mbrojtësi i të pandehurit N. M., Av. Mustafë Kastrati deklaroi “ Në tersi e mbështes fjalën e prokurorit të nderuar dhe shtoj se deklarimi i sotëm i sinqertë i të akuzuarit N. dhe dy të akuzuarve të tjerë argumenton se qysh në këtë fazë të procedurës është arritur qëllimi parandalues dhe resocializues, raportet e mira në mes këtu të akuzuarve janë argument shtesë që gjykatën ta lusim me rastin e marrjes së vendimit në lidhje me lartësinë e dënimit këto rrethana të merr si rrethana lehtësuese dhe mundësisht të ju shqiptoj një dënim sa më të butë”.

I pandehuri Xh. H. deklarori “ Pajtohem me të gjitha ato që u deklaruan nga prokurori dhe mbrojtësi parafolës, e konfirmoj se ne jemi pajtuar në mes veti dhe nuk kemi asnjë problem, na ka ndodhur diçka e momentit nuk ka qenë e planifikuar, shpreh keqardhje dhe kërkim falje për palën e dëmtuar”.

I pandehuri I. H. deklaroi “ Edhe unë e ndaj të njëjtin mendim me Xh., përkatësisht pajtohem me deklaratimet e prokurorit dhe mbrojtësit, ne jemi pajtuar ne mes veti shprehi keqardhje dhe kërkim falje për palën e dëmtuar”.

I pandehuri N. M. deklaroi “ Pajtohem me prokurorin dhe mbrojtësin tim, jemi pajtuar ne mes vete dhe ndjej shumë keqardhje për atë që ka ndodhur sepse ka qenë momentale e rastit dhe ju kërkoj falje edhe njëherë të dëmtuarve”.

B. Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe renduese të çështjes.

Përcaktimi i dënimit me burgim prej 2 (dy) vitesh për të pandehurin N. dhe dënimit prej 1 (një) viti për të pandehurit Xh. dhe I. u bë dukë e filluar matjen e dënimit nga pikënisja e dënimit, që sipas praktikës gjyqësore dhe udhëzuesit të Gjykatës Supreme, pikënisje është pika e mesme e minimumit dhe maksimumit të dënimit për veprën penale përkatëse. Në këtë rast pikë e mesme e dënimit për veprën penale të kryer nga i pandehuri N. është dënimi prej dy vite e gjashtë muaj burgim, ndërsa për veprën penale të kryer nga të pandehurit Xh. dhe I. është dënimi me burgim prej një vit e gjashtë muaj¹.

Pastaj, duke vlerësuar rrethanat renduese dhe lehtësuese të rastit, duke bërë peshimin e tyre si dhe duke aplikuar dispozitat ligjore përkatëse për matjen e dënimit, gjykata vendosi për dënimin me burgim të shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurit nuk kemi fare rrethana renduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të

¹ Udhëzues për Politiken Ndëshkimore i Gjykatës Supreme të Kosovës, fq 201.

bërë në seancën e shqyrtimit fillestar, faktin se te pandehurit tashme janë pajtuar dhe keqardhjen e shfaqur nga të pandehuri me rastin e pranimit të fajësisë, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kur u vendos për kushtëzimin ekzekutimit të dënimit me burgim gjykata u bazua në nenin 46, 48 par.1 dhe 2 dhe 49 par.1 dhe 3 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoj se me shqiptimin e dënimit më kusht ndaj të pandehurve do të arrihet të realizohet në tersi qëllimi i dënimit, pasi që ky dënim do të ndikoj në rehabilitimin e të pandehurve, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit . Tërheqja e vërejtjes të pandehurve se nëse në periudhën verifikuese prej dy përkatësisht katër vitesh do të kryej vepër tjetër penale ndaj tyre do ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që të parandaloj të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kusht në përputhje me nenin 49 par.1 të KPRK-së ku thuhet “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, e në këtë rast siç u përshkrua më lartë për veprën penale që është shpallur fajtor i pandehuri N. është paraparë mundësia e shqiptimit të dënimit me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet ndërsa për te pandehurit Xh. dhe I. është parapare mundësia e shqiptimit të dënimit me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurve është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga të pandehurit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nën 450 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Kërkesë pasurore juridike nuk pati, siç parashihet nenin 458 par.1 të KPRK-së, si rrjedhojë gjykata nuk vendosi për kompensim te demit e as nuk e udhëzoi në kontest civil të dëmtuarit. Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.326/21, me datë 28.04.2023

Procesmbajtësja

Shpresa Kërnje

Gjyqtari i vetëm gjykues

Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.